



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË**



Në mbështetje të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, (Ligji Nr.03/L-040), neni 12, 40.2 shkronja (a), Ligji për Tregtinë e Brendshme (Ligji Nr.2004/18), neni 40, dhe bazuar në Statutin e Komunës së Malishevës, neni 12, 19.7 shkronja (e) - Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur, më **12/04/2010**, miratoi këtë:

**R R E G U L L O R E**  
**PËR ORARIN E PUNËS TË SUBJEKTEVE AFARISTE NË**  
**TERRITORIN E KOMUNËS SË MALISHEVËS**

*I. Dispozitat e përgjithshme*

**Neni 1**

Me këtë Rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës në lëmin e tregtisë, hotelerisë, zejtarisë dhe shërbimeve të tjera të subjekteve afariste në territorin e Komunës së Malishevës, me qëllim të ofrimit të shërbimeve dhe organizimin më të mirë të jetës së qytetarëve.

**Neni 2**

Të gjitha subjektet afariste të themeluara dhe të regjistruara në bazë të dispozitave ligjore, shoqëritë aksionare, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara, bizneset individuale, zejtaritë, ortakëritë etj, që veprojnë në territorin e Komunës së Malishevës, janë të obliguara t'i përmbahen orarit të punës të përcaktuar me këtë Rregullore.

### **Neni 3**

Orari i fillimit dhe i mbarimit të punës i përcaktuar me këtë Rregullore duhet të vendoset nga personat përgjegjës të subjekteve afariste në vend të dukshëm të objektit në të cilën kryhet veprimtaria afariste.

Duhet saktësuar orarin e punës para dhe pas dite, kohën e pushimit si dhe ditët që nuk punohet.

## *II. Koha e punës*

### **Neni 4**

4.1. Përcaktohet orari i punës për periudha dhe intervale (sezona) kohore:

-periudha verore fillon, më 01/04 dhe zgjatë deri më 30/10 të vitit;

-periudha dimërore fillon, më 01/11 dhe zgjatë deri më 31/03 te vitit.

4.2. Të dielave nuk do të punohet, me përjashtim të atyre subjekteve afariste të lejuara sipas kësaj Rregulloreje.

4.3. Orari i punës i dyqaneve zejtare

-në periudhën verore prej orës ..... 07:00 deri 20:00;

-ne periudhën dimërore prej orës ..... 08:00 deri 18:00.

4.4. Furrat e bukës kanë të drejt të punojnë çdo ditë nga 24h.

4.5. Të dielave do të punojnë sallonet e ondulimit për femra, kurse ditë pushimi do ta kenë ditën e martë.

Përjashtimisht edhe të marteve kanë të drejtë të punojnë prej datës 01/06 deri 15/09.

4.6. Orari i punës i vetëshërbimeve,supermarketeve,marketeve(gjëra ushqimore), dyqaneve tregtare, depove të materialit ndërtimor,depove të artikujve ushqimor dhe jo ushqimorë,ndërmarrjet ndërtimore do të jetë ky orar:

-në periudhën verore prej orës ..... 07:00 deri 21:00;

-në periudhën dimërore prej orës ..... 08:00 deri 19:00.

4.7. Të dielave do të jenë kujdestarë në qytetin e Malishevës 4 subjekte afariste,të cilat bëjnë furnizimin me artikuj ushqimorë, dhe atë nga një subjekt afarist në secilën rrugë kryesore, si dhe nga një barnatore shëndetësore dhe bujqësore brenda qytetit.

Kujdestarinë për subjektet afariste e cakton Drejtoria e Inspektoratit,(Inspektori i Tregut).

## **Neni 5**

5.1. Orari i punës për hotele dhe motele është:

-në periudhën verore prej orës ..... 06:00 deri 24:00;

-në periudhën dimërore prej orës ..... 07:00 deri 23:00.

Ndërsa pranimi i mysafirëve për fjetje mund të bëhet nonstop 24 orë.

## **Neni 6**

6.1. Orari i punës për kafiteritë, internet-kafet, CD-shop, bastoret e ndryshme është:

-për periudhën verore prej orës ..... 07:00 deri 24:00;

-për periudhën dimërore prej orës ..... 08:00 deri 23:00.

6.2. Restorantet, ëmbëltoret, çajtoret e të ngjashme do të punojnë me këtë orar:

-për periudhën verore prej orës ..... 07:00 deri 23:00;

-për periudhën dimërore prej orës ..... 08:00 deri 22:00 .

6.3. Klubet e natës, e të ngjashme do të punojnë me këtë orar:

-gjatë periudhës verore dhe dimërore prej orës 20:00 deri 04:00.

6.4. Diskoklubet do të punojnë të premteve dhe të shtunave:

-gjatë periudhës verore dhe dimërore prej orës 20:00 deri 04:00;

-kurse të dielave gjatë periudhës verore dhe dimërore prej orës 20 deri 02:00.

6.5. Kazinot dhe lojërat e fatit do të punojnë prej orës 18:00 deri 03:00.

6.6. Të gjitha subjekteve afariste në tërë territorin e KK Malishevës, ju ndalohet ta prishin qetësinë me muzikë live, apo në forma tjera qytetarëve, si dhe atyre që banojnë në afërsi të subjekteve afariste .

## **Neni 7**

7.1. Tregjet ditore do të punojnë me këtë orar:

-për periudhën verore prej orës ..... 06:00 deri 16:00;

-për periudhën dimërore prej orës ..... 08:00 deri 15:00;

-të dielave tregu i gjelbër (ditor) prej orës .... 09:00 deri 13:00.

7.2. Ndërsa tregjet javore do të punojnë me këtë orar:

-tregu i gjelbër, i automjeteve (autotregu), i kafshëve do të punojnë vetëm të enjteve

-për periudhën verore prej orës ..... 06:00 deri 16:00;

-për periudhën dimërore prej orës ..... 07:00 deri 15:00.

## **Neni 8**

Në objektet hoteliere,restorante të cilat gjenden në afërsi të objekteve të banimit, e në të cilat organizohet program i gjallë muzikor apo me audio video apo mjete për riprodhimin e programit nuk lejohet të mbahet pas orës 23:00 ne afërsi te drejtpërdrejtë 100 m. nga objektet e banimit.

## **Neni 9**

9.1. Subjektet afariste për shitjen e karburanteve kanë të drejtë të punojnë si gjatë periudhës verore ashtu edhe atë dimërore prej orës 06:00 deri 24:00

9.2. Një pikë furnizimi me karburant do të kujdestaroj non stop 24 orë. Orarin e kujdestarisë do ta caktojë Drejtoria e Inspektoratit,(Inspektori i Tregut).

## **Neni 10**

10.1. Barnatoret, ordinancat,poliklinikat private do të punojnë me ketë orar:  
-për periudhën verore prej orës ..... 07:00 deri 22:00  
-për periudhën dimërore prej orës ..... 08:00 deri 20:00

10.2. Një barnatore do të kujdestarojë gjatë ditëve të punës non stop 24 ore. Orarin e kujdestarisë do ta përcaktoj Drejtoria e Inspektoratit (Inspektori i Tregut).

## **Neni 11**

11.1. Për të gjitha subjektet, të cilat do të kujdestarojnë orari i kujdestarisë caktohet sipas radhitjes alfabetike të mbishkrimeve të subjekteve afariste dhe të gjitha subjektet afariste e kanë për obligim që ta vendosin orarin e kujdestarisë ne lokal në vend të dukshëm.

## **Neni 12**

12.1. Ndërmarrjet Transportuese, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në territorin e komunës së Malishevës, që bëjnë transportimin e udhëtarëve me autobus,kombitaksi duhet t'i përmbahen orarit të përcaktuar nga KK i Malishevës.

### *III. Zgjatja e orarit te punës*

## **Neni 13**

13.1. Restaurantet,kafebaret,hotelet,motelet,vetësherbimet,supermarketet,dyqanet tregtare (me gjera ushqimore)etj, mund të punojnë me gjatë se orari i përcaktuar me këtë Rregullore vetëm me pagesë për zgjatje të orarit të punës.

13.2. Për zgjatjen e orarit të punës duhet bërë kërkesë nga subjekti afarist në Zyrën e Pritjes në KK,drejtuar Drejtorisë së Inspektoratit.

13.3. Drejtoria e Inspektoratit me vendim të posaçëm jep pëlqim për zgjatjen e orarit të punës për subjekte afariste.

13.4. Për çdo orë pune të zgjatur pas orarit të rregullt të punës me dhënien e pëlqimit për zgjatje te orarit të punës duhet paguar:

-për subjektet afariste si hotelet,motelet,restorantet,kafebaret, etj ..... 10. €.

-supermarketet,vetëshërbimet dyqanet tregtare etj,..... 5. €

#### **Neni 14**

Subjektet shërbyese hoteliere mund të zgjasin orarin e punës në rastet e ditëve të festave zyrtare të përcaktuar me ligj si dhe me rastin e ditës së 16 Qershorit, deri në orën 02:00. Zgjatja e këtij orarit të punës do të jetë pa pagesë.

### *IV.Dispozitat ndëshkuese*

#### **Neni 15**

15.1. Subjektet afariste të cilat punojnë në kundërshtim me nenin 4.2 të kësaj Rregullore nëse hasen nga Inspektori komunal i tregut apo nga inspektorët kujdestar, dhe Policia konsiderohen se kanë bërë kundërvajtje, dhe me këtë rast do të paraqitet kërkesa për dënim në Gjykatën kompetente, kundërvajtëse, e cila do ta dënojë në shumën prej :

-personin juridik (subjektin afarist) ..... 300-500 €

-personin përgjegjës të subjektit afarist ..... 200-300 €

15.2. Te gjitha subjektet afariste, të cilat nuk do ta respektojnë fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të paraqitur sipas kësaj Rregulloreje, e që konstatohet nga Inspektori komunal i tregut apo nga inspektorët kujdestarë, dhe Policia konsiderohen se kanë bërë kundërvajtje dhe me këtë rast do të paraqitet kërkesa për dënim në Gjykatën kompetente, kundërvajtëse, e cila do ta dënojë në shumën prej :

-personin juridik (subjektin afarist) ..... 200-300 €

-personin përgjegjës të subjektit afarist ..... 150-250 €

15.3. Subjektet afariste nëse veprojnë në kundërshtim të nenit 6.6 dhe 7.2, të kësaj Rregulloreje dhe konstatohet nga organet kompetente komunale, kanë bërë kundërvajtje me këtë rast lënda do të procedohet në Gjykatën kompetente për kundërvajtje, ku gjykata do t'i dënojë, dhe atë në shumën prej:

-personin juridik (subjektin afarist) ..... 500-1000 €

-personin përgjegjës te subjektit afarist .....300-500 €

## *V. Dispozitat kalimtare dhe të fundit*

### **Neni 16**

Organet komunale si dhe personat përgjegjës të subjekteve afariste janë të obliguar që të harmonizojnë orarin e punës me dispozitat e kësaj Rregulloreje, menjëherë nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

### **Neni 17**

Implementimin e kësaj Rregulloreje e bën Drejtoria e Inspektoratit, Policia e Kosovës-Malisheve.

### **Neni 18**

Me miratimin e kësaj Rregulloreje bie nga fuqia Rregullorja nr.01/63 e datës 30/01/2004.

### **Neni 19**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i Komunës së Malishevës.

KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Nr. 01/\_\_\_\_\_

Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_ 2010

Kryesuesi i Kuvendit  
Ragip Begaj

---